



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:043358

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05414276

Pml.nr.133/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit D. K. etj, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Grabitje nga neni 317, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësja e të pandehurit D. K., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.31/2024 datë 07.02.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN.DKR.nr.146/24, të datës 14.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit D. K., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.31/2024 datë 07.02.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN.DKR.nr.146/24, të datës 14.02.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.31/2024 datë 07.02.2024, të pandehurit D. K., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Grabitje nga neni 317 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të KPRK, i ka caktuar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e llogaritur prej datës 06.02.2023 deri më 06.03.2024. Paraburgimi të pandehurit i është caktuar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1., dhe 1.2, pikat: 1.2.1 , 1.2.2 dhe 1.2.3 e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.DKR.nr.146/24 e datës 14.02.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurit D. K., etj., dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të pandehurit D. K., avokate Merita Bogaj avokate nga P., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, t`a aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, t`i anuloj aktvendimet e atakuara si të pa bazuara apo të ndryshohet masa e paraburgimit në mënyrë që të pandehurit t`i shqiptohet ndonjëra nga masat alternative më të buta nga neni 171, përfshirë edhe arrestin shtëpiak.

Kryeprokurori të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.56/24 e datës 28.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësja e të pandehurit pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike kur kanë aplikuar dispozitën e nenit 184 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 pikat: 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, duke mos dhënë asnjë shpjegim të vetëm që do të justifikonte cilën do nga tri bazat ligjore. Prokurori i çështjes, nuk ka arritur t`a vërtetoj dyshimin e bazuar dhe individualizimin e përgjegjësisë, e aq më pak të ketë argumentuar veprimet inkriminuese, se i mbrojturi i saj ka kryer apo ka ndërmarr veprime në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën ngarkohet. Po ashtu theksohet se gjykata bënë aplikim të gabuar të drejtës materiale, në dëm të mbrojtësit të saj, kur të pandehurit i cakton masën e paraburgimit, pasi që të gjitha veprimet e të mbrojturit të saj përjashtojnë përgjegjësinë penale. E po ashtu theksohet se i pandehuri ndodhet në një gjendje të rëndë ekonomike, se ka nënën në gjendje të rëndë shëndetësore, e cila ka nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe mbështetje permanente dhe se mbajtja e të mbrojturit të saj tutje në paraburgim do të ndikoj drejtpërdrejt në keqësimin e mirëqenies së familjes dhe gjendjes shëndetësore të nënës së tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara, ngase si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë dhënë arsye të mjaftueshme për bazat ligjore të caktimit të paraburgimit. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprës penale për të cilën dyshohet, me çka është plotësuar kushti ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të KPP, për caktimin e paraburgimit.

Po ashtu, sipas kësaj Gjykate, qëndron baza ligjore nga dispozita e nenit 184 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit

D. K., nga fakti se po të gjendet i njëjti duke u mbrojtur në liri, lehtë mund të ik-arratiset dhe të ndikoj në rrjedhën normale të procedurës në këtë çështje penale, marrë parasysh peshën e veprës penale dhe sanksionin e paraparë për këtë vepër penale që mund ti shqiptohet nëse shpallet fajtor, andaj me qëllim të rrjedhës normale të procedurës, në këtë fazë të hetimeve, caktimi i paraburgimit është më se i nevojshëm.

Qëndron, po ashtu edhe baza ligjore nga dispozita e nenit 184 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, për caktimin e paraburgimit ndaj të pandehurit D. K., duke marrë parasysh rrethanat e rastit, se i njëjti mund të ndikoj në rrjedhën normale të procedurës duke ndikuar në të bashkëpandehurit e tjerë, në atë mënyrë që të koordinohen për deklaratimet para prokurorit të shtetit në favor të tyre, e po ashtu edhe në të dëmtuarit E. K. dhe G. G.

Gjithashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, qëndron baza ligjore nga neni 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. pika 1.2.3 të KPP, ndaj të pandehurit në fjalë, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale e që në rastin konkret bëhet fjalë për vepër penale grabitje, pastaj karakteristikat e tija personale, nga se ashtu siç shihet nga shkresat e çështjes gjegjësisht të dhënat për të kaluarën e tij kriminale të paraqitura nga Policia e Kosovës, si dhe të dhënat nga gjykata, i pandehuri Diar, rezulton të jetë recidivist i veprave penale, rrethana këto që e justifikojnë caktimin e masës së paraburgimit me qëllim të parandalimit të përsëritjes apo kryerjes edhe të veprave tjera penale.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative nga neni 171 i KPP, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurve në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.133/2024, më datë 05.03.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,
Rasim Rasimi